

HAMIT KABA

**KOSOVA NË KRYQËZIM GJEOPOLITIK: SHQIPËRIA,
JUGOSLLAVIA DHE FUQITË E MËDHA
1945-1948**

Abstrakt:

Artikulli 'Kosova në kryqëzim gjeopolitik: Shqipëria, Jugosllavia dhe Fuqitë e Mëdha 1945-1948' paraprihet nga një parathënie e shkurtër në trajtë hipotetike, në të cilën pretendohet t'i jepet përgjigje pyetjes se, pse qeveria shqiptare nuk i paraqiti pretendimet e saj për Kosovën në Konferencën e Paqes të Parisit të vitit 1946? Pjesa e parë e artikullit merret me bashkimin e detyruar të Kosovës me Jugosllavinë Federative, me qëndrimin e Shqipërisë, Bashkimit Sovjetik e ish Aleatëve të Mëdhenj Perëndimorë të Luftës (SHBA dhe Britania e Madhe) ndaj çështjes së Kosovës, në periudhën janar 1945-qershor 1946. Problemi i Kosovës nuk u bë pjesë e agjendës ndërkombëtare. Ajo u konsiderua si një çështje e brendshme e Jugosllavisë, 'zgjidhja afatgjatë' e së cilës do t'i lihej vullnetit të Jugosllavisë e Shqipërisë dhe regjimeve komuniste të vendosura në të dy vendet. Pjesa e dytë e artikullit fokusohet tek problemi i Kosovës në vitet e miqësisë dhe të ndarjes së Shqipërisë me Jugosllavinë (qershor 1946-qershor 1948). Pas Konferencës së Paqes të Parisit problemi i Kosovës u konsiderua si një çështje që mund të zgjidhej përmes krijimit të Federatës Ballkanike. Kjo ide u mbështet parimisht edhe nga Stalini, por zbatimi i saj u frenua e ndalua prej tij. Arsyet duhen kërkuar tek dyshimet e Stalinit ndaj ambicieve hegjemoniste të Jugosllavisë në Ballkan e veçanërisht në Shqipëri, tek politika e pavarur e Tito-s ndaj BS, në rrethana ndërkombëtare të ndryshuara pas fillimit të Luftës së Ftohtë, tek qëndrimi i PKJ ndaj lëvizjes së komunistëve grekë etj. Keqësimi i marrëdhënieve të Jugosllavisë me Shqipërinë dhe vendet e tjera të Bllokut Komunist krijoi iluzion tek udhëheqja komuniste e Shqipërisë, se pas 'rrëzimit' të regjimit të Tito-s, Stalin-i mund të miratonte bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Letra e E. Hoxhës drejtuar

Stalin-it në vitin 1949 ndeshi në refuzimin e tij. Pas kësaj kjo çështje u 'arkivua'.

Për shkrimin e këtij artikulli janë shfrytëzuar burime arkivore shqiptare, jugosllave, ruse, amerikane e britanike, si dhe disa botime të fundit të rëndësishme.

Fjalë kyçe:

Kosova, Jugosllavia, Shqipëria, BS, SHBA, Britania e Madhe, Tito, Enver Hoxha, Stalin-i, marrëdhënia

Parathënie

Kërkesa e Shqipërisë për bashkimin e saj me Kosovën, sikurse pritej, nuk u paraqit nga qeveria shqiptare në asnjërën prej tri Konferencave të Këshillit të Ministrave të Jashtëm [në Londër- shtator 1945, në Moskë–dhjetor 1945, në Paris – prill 1946], të cilat përgatitën Konferencën e Paqes të Parisit [29 korrik-15 tetor 1946] dhe as në këtë të fundit. Si Shqipëria ashtu edhe Jugosllavia ishin ‘vende demokratike’, ndërsa rrethanat e brendshme dhe ato ndërkombëtare për disa arsye nuk e favorizonin paraqitjen e saj.

Së pari, shteti shqiptar dhe qeveria e tij, nuk e kishin as forcën, as vullnetin për të kërkuar zyrtarisht Kosovën, sepse Jugosllavia ishte aleatja dhe mbrojtësjë e regjimit komunist, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij, ndërsa pozita ndërkombëtare e Shqipërisë, në vitet e para të pasluftës ishte e dobët. Ajo nuk ishte pranuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, nuk kishte arritur të siguronte njohjen e qeverive amerikane e britanike dhe, nuk ishte njohur me statusin e një vendi aleat, apo të një fuqie shoqe në Konferencën e Paqes të Parisit etj.¹ Përkundrazi, Jugosllavia ishte një vend anëtar i Kombeve të Bashkuara, kishte qeveri të njohur nga SHBA dhe Britania e Madhe dhe, si vend zyrtarisht fitues i luftës, kishte siguruar pjesëmarrjen me të drejta të plota në Konferencën e

¹ Shqipëria u njoh si ‘fuqi shoqe’ nga Këshilli i Ministrave të Jashtëm, në takimin e New York-ut më 9 nëntor 1946, kur Konferenca e Paqes i kishte përfunduar punimet. Shih: *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti (më tej: *V.*) 1948, dosja (më tej: *D.*) 181, B/I-8, fl. 17. “Marrëdhëniet e R.P. të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik prej çlirimit e deri më sot”.

Paqes të Parisit. Jugosllavia, në vitet e para të pasluftës, konsiderohej si vendi më i suksesshëm i ‘Demokracive Popullore’ dhe më afër se kushdo tjetër me modelin komunist të Bashkimit Sovjetik. Ambasadori amerikan në Jugosllavi, Cavendish Cannon nga pikëpamja strategjike e konsideronte Jugosllavinë si “satelitin më të rëndësishëm të orbitës ruse dhe, në këtë kuptim i shkruante Sekretarit të Shtetit, ajo do të përfshijë Shqipërinë, e cila për të gjitha arsyt praktike mund të konsiderohet si Republika e Shtatë e Jugosllavisë... Regjimi i Titos, theksonte ai më tej, gëzon liri të konsiderueshme nga ndërhyrja sovjetike në ndërmarrjen e vendimeve të brendshme politike dhe në përcaktimin e ritmit të programeve komunistizuese. ...Nacionalizmi jugosllav mundet që në një ditë të mirë, të konfliktohet me qëllimet e sovjetikëve, por kjo nuk duket se është e mundur për aq kohë sa ruhet ndarja akute Lindje-Perëndim”.²

Së dyti, problemi i Kosovës nuk mund të shtrohej në një forum të madh ndërkombëtar, siç ishte Konferenca e Paqes e Parisit, pa siguruar më parë pëlqimin e vendeve mike, sikurse ishin Jugosllavia, BS, dhe vendet e ‘Demokracive Popullore’. Si Jugosllavia, ashtu edhe BS e shikonin çështjen e Kosovës, si një problem të brendshëm, që do të gjente zgjidhje me krijimin e Federatës Ballkanike. Pozita ndërkombëtare e Shqipërisë në vitet e para të pasluftës vazhdoi të mbetej e dobët, jo vetëm në raport me vendet e anës tjetër të ‘perdes së hekurt’, por edhe brenda bashkësisë së vendeve të ‘Demokracive Popullore’. Marrëdhëniet e Shqipërisë me një pjesë të këtyre vendeve në vitet 1945-1948, ka shkruar Enver Hoxha, si në nivelin partiak ashtu edhe në atë shtetëror, ishin pothuajse inekzistente.³ Me dashjen apo pa dashjen e saj, udhëheqja komuniste e Shqipërisë ishte futur në ‘sqtullën’ e Jugosllavisë, ndërsa rruga për në Bashkimin Sovjetik kalonte përmes saj.⁴

² *Foreign Relations of the United States* (më tej: *FRUS*), 1947, Volume IV, *Eastern Europe; The Soviet Union*, Washington: US Government Printing Office, 1972, f. 841-842. Memorandum i Cavendish Cannon (ambasador i SHBA në Jugosllavi), për Sekretarin e Shtetit, 7 shtator 1947.

³ Enver Hoxha, *Titistët, Shënime historike*, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 465.

⁴ Në letrën që Naxhije Dume i drejtonte udhëheqjes së lartë të PKSH nga Beogradi, më 30 mars 1945, vinte në dukje se, ajo së bashku me Nako Spirun, i kishin paraqitur Aleksandër Rankoviçit një kërkesë të PKSH, për t’u lidhur direkt me Moskën. Por, Rankoviçi ishte përgjigjur se, ‘duhet të prisnin dhe të dëgjonin jugosllavët’. Shih: *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 14/Arkivi i Partisë (më tej: AP), Lista 1, dosja (më tej: D.) 6, fl. 1; Më 27 maj

Së treti, problemi i Kosovës nuk ishte në agjendën e SHBA dhe të Britanisë së Madhe, pavarësisht se gjatë periudhës së luftës përfaqësuesit e tyre, kishin folur për mbajtjen e një plebishiti, apo për shqyrtimin e kësaj çështjeje në Konferencën e ardhshme të Paqes.⁵ Qeveritë e këtyre dy vendeve, sikurse kemi përmendur, e shihnin zgjidhjen e problemit të Kosovës tek gatishmëria e dy qeverive komuniste, të ardhura në pushtet si në Jugosllavi ashtu edhe në Shqipëri.

Nëse Shqipëria do ta kërkonte zyrtarisht diskutimin e çështjes së Kosovës në Konferencën e Paqes të Parisit dhe bashkimin e saj me Shqipërinë, ajo do të kundërshtohej si nga ‘armiqtë’, ashtu edhe nga miqtë. Ajo do të armiqësohej në radhë të parë me aleatën e saj të ngushtë Jugosllavinë, por edhe me BS dhe vendet e tjera komuniste të Evropës Lindore e Qendrore. Asnjë nga delegacionet e vendeve të ‘Demokracive Popullore’, që merrnin pjesë në Konferencën e Paqes me të drejtë vote, si Polonia, Çekoslovakia, Ukraina e Bjellorusia, nuk kishte gjasa, që të mbështesnin kërkesën e Shqipërisë. Ca më shumë nuk mund të gjente

1946, Tito e kishte njohur Stalinin me dëshirën e Enver Hoxhës e të Koçi Xoxes për të vizituar Moskën, ndërsa Molotovi ishte përgjigjur se ‘ne e kemi frenuar synimin e shqiptarëve për të ardhur në Moskë, por shqiptarët ngulin këmbë për këtë’. Stalini po kështu ishte shprehur kundër shkuarjes së tyre në Moskë, duke sjellë si argument reagimin e mundshëm të anglezëve dhe amerikanëve, që do ta rëndonin më shumë gjendjen e politikës së jashtme të Shqipërisë’, shih: *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse, 1946-1962*, përgatitën për botim, Hamit Kaba, Ethem Çeku, botim i dytë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Flamuri, 2017, f. 24; Edhe kur Enver Hoxha u takua me Stalinin në Moskë në korrik 1947, ky i fundit e orientoi sërish drejt Jugosllavisë. “Ne nuk ju ndihmojmë dot drejtpërdrejt, u shpreh Stalini, por ndihmat do t’ua japim nëpërmjet Jugosllavisë, pse po t’jua japim drejtpërdrejt dhe po të marrin vesh anglo-amerikanët, do të përpiqen të sjellin pengesa. ... Ju do ti bëni punët me anën e Jugosllavisë.., është mirë që ju keni Jugosllavinë aleate në kufi. Shqipëria është një vend i vogël dhe ka nevojë për një mbështetje të fortë”, shih: *AQSH, F.14/AP, V. 1947, D. 1, Lista 1, fl. 4, 4/1*; Madje edhe në takimin e organizuar në Moskë, më 17 janar 1948, ndërmjet Stalinit, Molotovit dhe Zhdanovit me Milovan Gjilasin ‘udhëheqësit sovjetikë deklaruan gatishmërinë e tyre për të plotësuar aspiratat jugosllave në lidhje me Shqipërinë’. Shih: Leonid Gibianskii, “The Beginning of the Soviet-Yugoslav Conflict and the Cominform”, in *The Cominform, minutes of the Three Conferences 1947/1948/1949*, edited by Giuliano Procacci, Fondazione Giangiacomo Feltrinelli, Milano: 1994, f. 474.

⁵ *The National Archives*, London (më tej: TNA), WO 201/2790, S.O.C. (43), 6th Meeting, 13th October, 1943, “Future of Kossovo”, cituar nga: Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, Tiranë: Toena, 2014, f. 156; Hamit Kaba, *Nga lufta në paqe, Shqipëria dhe SHBA 1939-1946*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2020, f. 221.

mbështetjen e Jugosllavisë, e cila u bë mbrojtësja dhe interpretoja e kërkesave të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare [në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, Konferencën e Paqes të Parisit etj.⁶ Neni 3 i Traktatit të Miqësisë dhe Ndhimës Reciproke i jepte të drejtë Jugosllavisë, që të ndihmonte ushtarakisht Shqipërinë ndaj ‘kujtdo tjetër që ka qëllim të cenojë pavarësinë e saj’, duke nënkuptuar me këtë në radhë të parë Greqinë.⁷

Përfaqësuesit e SHBA, Bashkimit Sovjetik, Britanisë së Madhe dhe Francës në Këshillin e Ministrave të Jashtëm, të ngarkuar të përgatisnin traktatet e paqes me vendet humbëse - ish aleate të Gjermanisë [Italinë, Rumaninë, Bullgarinë, Hungarinë dhe Finlandën], me siguri do ta kishin refuzuar kërkesën e Shqipërisë për Kosovën, nëse ajo do të ishte paraqitur në tre takimet e tyre në prag të Konferencës së Paqes të Parisit. Por, edhe nëse kërkesa e Shqipërisë për Kosovën do të kishte arritur ta shmangte Këshillin e Ministrave të Jashtëm dhe të shtrohej direkt në Asamblesë të Konferencës së Paqes, të përbërë nga 21 vende anëtare me të drejtë vote, me siguri që do të ishte refuzuar. Teknikisht, Shqipëria do ta kishte pasur gati të pamundur të arrinte që të vendoste në rendin e ditës të Asamblesë së Konferencës së Paqes, kërkesën e saj për Kosovën dhe të anashkalonte Këshillin e Sigurimit, sepse nuk e kishte statusin e një vendi anëtar, apo të një fuqie shoqe dhe as mbështetjen e shumicës së këtij organizmi.⁸ Shqipëria u pranua në Konferencën e Paqes me statusin e një

⁶ *AMPJ*, V. 1948, D. 181, B/I-8, fl. 11, 13-15, 17. “Marrëdhëniet e R.P. të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik prej çlirimit e deri më sot”, Drejtoria Politike, Sektori I, 3 tetor 1948.

⁷ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1944-1948*, vëll. I (Dokumente), përgatitja dhe redaktimi Sabit Sylja, Qerim Lita, përktheu nga gjuha serbo-kroate Albana Asani, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë: 2020, f. 268.

⁸ Nëse do të sillnim si shembull mënyrën se si veproi qeveria greke për të paraqitur kërkesën për aneksimin e Shqipërisë së Jugut dhe për fatin e saj në Konferencën e Paqes së Parisit të vitit 1946, do të vinim re se: Pretendimet e Greqisë për Shqipërinë e Jugut u refuzuan nga Këshilli i Ministrave të Jashtëm (takimi i Londrës), sepse objekt i saj dhe i dy konferencave pasardhëse ishte përgatitja e Traktateve të Paqes me vendet humbëse të luftës, aleate të Gjermanisë, ndërsa Shqipëria nuk ishte pjesë e tyre. Sidoqoftë, qeverisë greke, sikurse i ishte premtuar nga aleatët anglo-amerikanë gjatë Luftës së Dytë Botërore, nuk iu mohua e drejta që t’i paraqiste pretendimet e saj në Konferencën e Paqes së Parisit, asambleja e së cilës madje miratoi edhe një rezolutë të posaçme, që kjo çështje t’i kalonte për diskutim Këshillit të Ministrave të Jashtëm, si i vetmi institucion që kishte të drejtën e marrjes së një vendimi përfundimtar. Por, delegacioni grek, duke e konsideruar të pamundur arritjen e këtij qëllimi e tërhoqi rezolutën. Përfundimisht, pretendimet greke u diskutuan në Konferencën e Paqes, por

vendi konsultativ, që thjesht do të paraqiste objeksionet e veta për Traktatin e Paqes me Italinë, pas propozimit të përfaqësuesit të Jugosllavisë, [Moshe Pijades], dhe mbështetjes së dhënë nga përfaqësuesit e BS dhe vendeve të tjera komuniste. Por, edhe nëse supozohet që Shqipëria do ta kapërcente këtë pengesë dhe do arrinte që ta shtronte për diskutim kërkesën e vet në Asamblenë e Konferencën e Paqes, madje edhe të siguronte mbështetjen e shumicës së anëtarëve, vendimin përfundimtar do të duhej ta merrte Këshilli i Ministrave të Jashtëm, i cili bazohej tek parimi i unitetit në marrjen e vendimeve, por edhe tek e drejta e përdorimit të vetos. Edhe nëse Shqipëria, do të arrinte të siguronte mbështetjen e përfaqësuesve të SHBA, Britanisë së Madhe e Francës në Këshillin e Ministrave të Jashtëm [të cilët mund ta shfrytëzonin këtë çështje, për të bërë diversion në kurriz të BS, dhe vendeve të ‘Demokracive Popullore], me siguri që përfaqësuesi i BS do të aktivizonte të drejtën e vetos. E humbura më e madhe në këtë rast, do të ishte Shqipëria dhe qeveria e saj, e cila do të mbetej fillikat dhe pa asnjë vend aleat.

Ripushtimi i Kosovës nga Jugosllavia: qëndrimi i Shqipërisë dhe i aleatëve anglo-amerikanë (janar 1945 - qershor 1946)

Çështja e Kosovës dhe shqiptarëve në Jugosllavi, si për çdo qeveri tjetër shqiptare, do të vazhdonte të mbetej një barrierë e vështirë për t’u kapërcyer. Ajo do të ndikonte fort mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të pasluftës së Dytë Botërore. Parimi i vetëvendosjes i ofruar nga Karta e Atlantikut, nuk gjeti zbatim për Kosovën, pavarësisht nga dëshirat e shqiptarëve për t’u bashkuar në një shtet të përbashkët, të cilat u shprehën qartazi në rezolucionin e Konferencës së Bujanit, i anuluar nga letra e KQ e PKJ e datës 28 mars 1944.⁹ E ardhmja e Kosovës brenda Jugosllavisë u

nuk u miratuan. Në ato rrethana, duke mos paragjykuar të drejtën e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, mund të shtrojmë pyetjen: se çfarë mund të kishte arritur Shqipëria nëse do të kishte kërkuar zyrtarisht Kosovën në Konferencën e Paqes së Parisit? Përgjigja ime do të kishte qenë ‘asgjë’, përveçse kjo çështje do t’i kthehej në bumerang shtetit të dobët shqiptar, i cili do të humbte mbështetjen e të gjithëve dhe do të mbetej pa aleat. (Për më shumë shih: H. Kaba, *Nga lufta në paqe, Shqipëria dhe SHBA ...*, f. 237-238).

⁹ Fehmi Agani, “Konferenca e Bujanit dhe mëvetësia e Kosovës”, *Studime historike*, nr. 1-4/1992, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1994, f. 93, 95.

formësua në “vendimet e Mbledhjes së Dytë të AVNOJ-t, që i dhanë fund dilemës së tërësisë territoriale të Jugosllavisë, e në këtë kuadër dhe të përfshirjes së shqiptarëve në Federatën e Sllavëve të Jugut”.¹⁰ Ky projekt u konfirmua në bisedimet e zhvilluara për organizimin e shtetit të ri jugosllav në ishullin e Vis-it, në verën e vitit 1944, kur Tito, Eduard Kardeli dhe Vladimir Bakariqi pranuan që Kosova do të bëhej një provincë autonome, pra, që ajo të ishte pjesë integrale e detyrueshme e Jugosllavisë.¹¹ Më 2 gusht 1944 u konstituua njësi federale maqedone si pjesë përbërëse e Jugosllavisë së re, brenda së cilës u përfshinë edhe territoret e Maqedonisë Perëndimore, të banuara nga shqiptarët.¹²

Udhëheqja e re e Jugosllavisë vendosi kontrollin e saj mbi Kosovën, si njësi që i përkiste shtetit të ri federativ jugosllav. Mbi Kosovën dhe popullsinë shqiptare në mbarim të luftës u shkarkua mllefi nacionalist dhe ideologjik i udhëheqjes komuniste të Titos. Ushtria jugosllave u fut në Kosovë dhe ushtri dhunë e terror mbi shqiptarët, të cilët iu kundërpërgjigjën me rezistencë të armatosur dhe revolta masive. Në dhjetor 1944 në to u përfshinë pjesë të ndryshme të Kosovës, por qëndresa më e fuqishme u zhvillua në Drenicë në periudhën dhjetor 1944- shkurt 1945. Drenica, sipas raportit të Shtabit të divizionit 46 të UNÇJ-së drejtuar Shtabit të Korpusit 13 të UNÇJ, datë 22 nëntor 1944 dhe Raporti i Shtabit Operativ për Kosovë e Metohi drejtuar Shtabit Qendror të UNÇ dhe NJP për Serbinë të datës 4 dhjetor 1944 - tregojnë për veprimtari të fuqishme të grupeve të organizuara e të armatosura shqiptare, në rajonin e Kosovës dhe rrethinës: “Bandat shqiptare e filluan aktivitetin e tyre të armatosur. Grupe të caktuara gjenden në gjithë rajonin e Drenicës ku gjendet edhe shtabi i tyre me radio-stacion...”.

Shqiptarët e Kosovës e kundërshtuan ribashkimin e territoreve të tyre me Jugosllavinë dhe vendosjen e regjimit komunist. Si rezultat ata dhe u përballën me veprimet hakmarrëse të tij. Terrori dhe dhuna në

¹⁰ A. Lalaj, *Dosjet e Luftës...*, f. 203.

¹¹ Ky koncept i udhëheqjes jugosllave iu bë i qartë edhe udhëheqjes shqiptare në mesin e gushtit të vitit 1944, gjatë takimit të delegacionit shqiptar, të përfaqësuar nga Ramadan Çitaku e Bedri Spahiu, me udhëheqjen komuniste jugosllave. Tito do t'i deklaronte delegacionit shqiptar se: “...as që mund të mendohej që Jugosllavia e re do të humbte territore; se Kosmeti do të ishte pjesë integrale e detyrueshme e Jugosllavisë”. Shih: Lefter Nasi, “Presioni i PKJ dhe braktisja e problemit kombëtar nga PKS 1943-1945”, *Kosova*, nr. 29/30, Instituti i Historisë, Prishtinë: 2008, f. 277.

¹² Shaqir Vukaj, *Rusia dhe Kosova (shënime të një diplomati)*, Tiranë: Enriko Kuço, 2007, f. 69.

Kosovë u institucionalizua me vendosjen e administratës ushtarake, me urdhër të Josip Broz Tito-s, më 8 shkurt 1945. “Në Kosovë, ka shkruar Vladimir Dedijer, ishin rreth 20.000-30.000 njerëz të armatosur që luftonin kundër forcave jugosllave... ushtria jugosllave bëri gjenocid gjatë vitit 1945 dhe në fillimin e vitit 1946”.¹³ “Vetëm nga të dhëna të pjesshme llogaritet se 36 000 shqiptarë ranë nga plumbi, bajoneta dhe helmi titist nga viti 1944 deri në vitin 1948. Masakrat nuk ishin drejtuar kundër reaksionarëve, por kundër popullit për ta shfarosur”.¹⁴ Pas këtyre masakrave, besimi i shqiptarëve të Kosovës tek ‘Jugosllavia e re’ u shua plotësisht. Ata do të vazhdonin të mbeteshin qytetarë të dorës së dytë, në një shtet që pretendonte se e kishte zgjidhur më mirë se kushdo tjetër çështjen kombëtare në Ballkan.

Statusi i Kosovës, pavarësisht nga propaganda e PKJ dhe e Tito-s u vendos nga lart, në kundërshtim me dëshirat e shumicës së shqiptarëve të dy anëve të kufirit dhe kundër vullnetit të tyre. Në mbarim të janarit të vitit 1945 udhëheqësit e PKJ, Aleksandër Rankoviç, Milovan Gjilas dhe Svetozar Vukmanoviç Tempo thirrën në Beograd, Miladin Popoviçin e Fadil Hoxhën dhe u bënë të ditur, se Kosova do të kishte autonomi formale e do t’i bashkëngjitej Serbisë, se do të mbahej vetëm flamuri i Jugosllavisë dhe i Serbisë, kurse flamuri shqiptar nuk duhej të dukej më.¹⁵ Moshe Pijade, në fillim të vitit 1945, kërkoi që kancelaria e re e Republikës Federative të Jugosllavisë në Beograd të mos kishte 6, por 7 kabinete. Kabineti i 7-të do t’i përkiste Republikës Jugosllave të Shqipërisë.¹⁶

Hapat e parë për përcaktimin zyrtar të statusit të Kosovës u hodhën në shkurt 1945 dhe përfunduan plotësisht në janar 1946, pas miratimit të Kushtetutës së Republikës Federative të Jugosllavisë. Vendimi që Kosova t’i bashkohej Serbisë u mor më 18 shkurt 1945, në një mbledhje të udhëheqjes më të lartë të Komitetit Qendror të PKJ, nën diktatin e përfaqësuesve serbë, në kushtet kur Kosova gjendej nën administrim

¹³ Vladimir Dedijer, *Novi Prilozi za Bijografiju Josipa Broza Tita*, Libri III, Belgrade: RAD, 1984, f. 164.

¹⁴ Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, botim i dytë, Prishtinë: 2017, f. 120.

¹⁵ *AMPJ*, V. 1963, D. 909 (B/VII-2), fl. 2. Relacion, “Të dhëna për Kosovën, gjatë e mbas luftës”, cituar sipas S. Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës...*, f. 120.

¹⁶ E. Hoxha, *Titistët ...*, f. 211, citon Vladimir Dedijer, *Novi Prilozi za Bijografiju J.B. Tito*, Rijeka: 1981, f. 902.

ushtarak. Për t'i dhënë legjitimitet këtij vendimi, më 7-9 prill 1945 u organizua Mbledhja e Jashtëzakonshme e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë në Beograd, ndërsa më 8-10 korrik në Prizren, u mbledh i ashtuquajtura Kuvend i Këshillit Popullor të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit.¹⁷ Në 'Kuvendin' e Prizrenit nga 137 pjesëmarrës vetëm 32 ishin shqiptarë, të cilët survejoheshin nga njerëz të armatosur të UDB (Unutrašnja dršavna bezbednost - Mbrojtja e Brendshme Shtetërore), u miratua me duartrokitje një rezolutë për aneksimin e Kosovës ndaj Serbisë, me "dëshirën" e popullit të Kosovës. Rajoni Autonom i Kosovës u sanksionua në Kushtetutën e Jugosllavisë të janarit të vitit 1946.¹⁸

Gjatë takimit që J. B. Tito zhvilloi me Mehmet Hoxhën (kryetar i Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës) dhe me Dushan Mugoshën (sekretar i këtij Këshilli) më 7 prill 1945, foli për dallimet e Jugosllavisë së vjetër me Jugosllavinë e re dhe trajtimin krejtësisht ndryshe që do të kishin shqiptarët e Kosovës.¹⁹ Shqiptaro-amerikani Stephen Peters [anëtar i Misionit të OSS-Office of Strategic Services në Shqipëri] i transmetonte qendrës së tij pjesë të fjalës së mbajtur nga Tito në takimin e mësipërm: "Ne po krijojmë një shtet të ri, në të cilin shqiptarët do të ndjehen si qytetarë me të drejta të barabarta, ku askush nuk do t'i nëpërkëmbë..., populli shqiptar është krenar, punëtor i zellshëm, të ndershëm dhe për këto arsye ata munden dhe duhen të bëhen faktorë të rëndësishëm në rindërtimin e Jugosllavisë së re ..., shumica e popullit shqiptar nuk pyet për kufijtë ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë, sepse e dinë që vetëm marrëdhëniet e ngushta dhe të përzemërta ndërmjet dy popujve janë garanci për Shqipërinë e pavarur dhe se kjo pavarësi nuk mund të garantohet nga përpjekjet e ndryshme agresive".²⁰ Por, sipas Vladimir Dedijer, Tito, në po atë takim, i akuzoi shqiptarët e Kosovës se '90% e tyre kishin qenë në anën e fashizmit'.²¹ Numri dy i PKJ, Edvard Kardeli, ka nënvizuar V. Dedijer, kishte paraparë tre variante për të

¹⁷ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990, grup autorësh, Tiranë: Toena, 2008, f. 341-342.

¹⁸ *Po aty*, f. 342.

¹⁹ V. Dedijer, *Novi Prilozi za Bijografiju J.B. Tita ...*, Libri III, f. 164.

²⁰ *The National Archives and Record Administration* (më tej: NARA), RG 226, Entry 16, File 130063, f. 2. Raport nr. 16 i Stephen Peters "Vështrime shqiptare për Kosovën", 19 maj 1945.

²¹ V. Dedijer, *Novi Prilozi za Bijografiju J.B. Tita ...*, Libri III, f. 164.

ardhmen e Kosovës: Sipas *variantit të parë*, Kosova do të ndahej sikurse Sanxhaku, midis Malit të Zi, Serbisë dhe Maqedonisë; *varianti i dytë* parashikonte një lloj autonomie të kufizuar në kuadër të Serbisë për Kosovën, dhe *varianti i tretë* që Kosova të bashkohej me Shqipërinë, por që Shqipëria të hynte në federatë me Jugosllavinë. Në fund u vendos të pranohej varianti i dytë, që Kosova t'i aneksohej Serbisë.²² Kosovës iu njoh statusi i një Qarku Autonom, në përbërje të Republikës Popullore të Serbisë.

Misionet britanike dhe amerikane në Shqipëri e në Jugosllavi, në mbarim të luftës dhe gjatë vitit 1945 ndiqnin me vëmendje zhvillimet e ngjarjeve, regjimet e ngjashme që po vendoseshin në këto dy vende dhe pasojat që do të sillte krijimi i Federatës Ballkanike. Përfaqësuesi politik i SHBA në Caserta, Alexander Kirk, në tetor 1944 shfaqte dyshimin se Tito dhe Hoxha ishin angazhuar në bisedime sekrete për të pranuar “kufijtë e vitit 1941 dhe, një marrëveshje në lidhje me çështjen e Kosovës”.²³ Misioni amerikan i OSS-së (Office of Strategic Services-Zyra e Shërbimeve Strategjike) në Shqipëri analizonte përmbajtjen e notës, që qeveria shqiptare u kishte drejtuar qeverive të Aleatëve të Mëdhenj për njohjen e saj, por nuk vinte re asnjë gjurmë të përmendjes së Kosovës.²⁴ Drejtuesi i misionit civil jo zyrtar të SHBA në Shqipëri, Joseph E. Jacobs në raportin që i drejtonte Departamentit të Shtetit (DSH) më 16 gusht 1945, i kishte kushtuar disa faqe problemit të kufijve shqiptaro-jugosllavë dhe projektit të Federatës Ballkanike. Ai i sugjeroi DSH që kufijtë ndërmjet të dy vendeve të korrigjoheshin, duke i kaluar Shqipërisë një pjesë e territoreve shqiptare në Jugosllavi. Sidoqoftë, për shkak të ndjeshmërisë së lartë historike të serbëve, diplomati amerikan nuk e rekomandoi bashkimin e të gjitha territoreve shqiptare nën Jugosllavi me Shqipërinë, por vetëm një pjesë të tyre. Ndryshimi i kufijve, sipas propozimit të Jacobs, do të shoqërohej me zhvendosjen e popullsisë përkatëse në të dyja anët e kufirit. Nga ky korrigjim, popullsia shqiptare do të zmadhohej dhe do të arrinte në rreth 1,5 milion banorë,

²² Владимир Дедијер, *Нови прилози за биографију Јосипа Броза Тита*, том 2, Ријека-Загреб: 1982, f. 895, 903-904.

²³ NARA, RG 59, 857.01/10.21 44. Telegram i Alexander Kirk [përfaqësues politik i Departamentit të Shtetit pranë Shtabit të Forcave Aleate të Mesdheut në Caserta] për Sekretarin e Shtetit, 21 tetor 1944.

²⁴ *Gazeta Bashkimi*, Organ Central i Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, Tiranë, 4 janar 1945.

ndërsa tokat e pasura të Kosovës do të shërbenin për ushqimin më të mirë të popullsisë shqiptare.²⁵ Sidoqoftë, territori dhe popullsia e shteti shqiptar edhe pas këtij bashkimi do të vazhdonte të ishte më e vogël se të gjithë shteteve të tjerë të Ballkanit. Jacobs, duke pasur në konsideratë dobësinë dhe rreziqet që i vinin shtetit shqiptar nga fqinjët e tij më të fuqishëm, i propozonte DSH mundësinë e krijimit të një Federate Ballkanike, ku të përfshiheshin Jugosllavia, Bullgaria, Rumania e mundësisht edhe Greqia.²⁶

Heshtja e qeverisë shqiptare për Kosovën u bë objekt kritikash nga misionet britanike e amerikane në Shqipëri dhe u shfrytëzua prej tyre. Gjatë një bisede me Liri Gegën, shefi i misioneve ushtarake britanike në Shqipëri, Alan Palmer kishte bërë pyetjen, “tash që Jugosllavia nuk është vend imperialist, a do të kërkonte Kosmetin?”²⁷ Gjenerali Hodgson [drejtues i Misionit Ushtarak Britanik në Shqipëri] habitej se si qeveria shqiptare nuk kishte dhënë asnjë deklaratë për qëndrimin e saj ndaj Kosovës, ndërsa masat e gjëra shqiptare, madje edhe nëpunësit shqiptarë nuk e dinin se në duart e kujt gjendej Kosova dhe as se si do të zgjidhej çështja e saj. Përfaqësuesin diplomatik të Jugosllavisë në Tiranë, Velimir Stojniçin e shqetësonte interesimi i Misionit Ushtarak Britanik për Kosovën. Më 12 korrik 1945 ai i raportonte qendrës së tij në Beograd se, “të gjithë oficerëve anglezë u intereson njëlloj çështja e Kosovës. U intereson shumë se çfarë mendojnë shqiptarët për Kosovën, nga fshatari e deri te kryetari i Këshillit dhe i Qeverisë.... Gjithashtu, vazhdonte më tej Stojniçi, Hodgson-i është shprehur se “Kosova e Metohia për Shqipërinë janë shumë më të rëndësishme se sa Epiri i Veriut”.²⁸ “Për sa më sipër, komentonte emisari jugosllav, mund të gjykohet se anglezët në Shqipëri, me punën e tyre përpiqen që çështjen e Kosovës e Metohisë ta shtrojnë para masave, ndërsa këtë çështje masat ta shtrojnë si kërkesë, me qëllim

²⁵ NARA, RG 59, 875.00/8-1645, f. 27-28. Raporti final i Misionit Special Amerikan në Tiranë, drejtuar Departamentit të Shtetit, Seksioni VI, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, 16 gusht 1945.

²⁶ *Po aty*.

²⁷ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1944-1948 ...*, vëll. I, f. 69, shih: AJ. 507, IX, 1/I-8, listova 14, 1945.

²⁸ *Po aty*, f. 110. Raport i Velimir Stojniçit, ministër Fuqplotë i Jugosllavisë në Shqipëri, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, “Situata politike në Shqipëri në gjysmën e parë të vitit 1945”, 12 korrik 1945, shih: AJ. 507, IX, 1/II-47.

që, të tronditej miqësia dhe marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë”.²⁹

Projekti i Federatës Ballkanike, në rrethanat e rajonit të ndarë, nuk pajtohej me interesat e Perëndimit e në veçanti të Britanisë së Madhe. Me bekimin e Moskës dhe me iniciativën e Titos, federata e re, që do të shtrihej nga deti Adriatik në Detin e Zi, do të ushtronte presion të madh mbi Greqinë dhe tërësinë e saj tokësore, si rezultat i pretendimeve jugosllave për Maqedoninë Greke me qendër Selanikun dhe rrezikun e bashkimit të Maqedonisë së Vardarit me Maqedoninë e Pirinit, ndërsa Greqia do të ndjehej e pafuqishme për t’u përballur me fqinjët e vet më të fortë. Nën trysninë e vendeve komuniste do të gjendej edhe Turqia, një vend që i përkiste gjithashtu sferës së influencës perëndimore. Pasojat negative të krijimit të Federatës Ballkanike u analizuan nga Komiteti i Shefave të Shtabit të Ministrisë Britanike të Luftës në dhjetor 1944.³⁰ Me shqetësimet e britanikëve në fillim të vitit 1945, u bashkuan edhe amerikanët, të cilët ia bënë të ditura edhe qeverisë sovjetike, e cila në janarin e vitit 1945 u detyrua që të modifikonte qëndrimin e saj ndaj krijimit të Federatës Ballkanike. “Duhet të jetë pikërisht ky qëndrim që ka ndikuar tek Stalini për të adoptuar një taktikë të re, jo marrëveshje për bashkim në një federatë, por traktat aleance dhe ndihmë të ndërsjellët midis Jugosllavisë dhe Bullgarisë”.³¹ Stalini, ka shkruar diplomati Shaqir Vukaj e frenoi krijimin e Federatës Jugosllavo-Bullgare, në takimin që pati me delegacionin jugosllav, më 9 janar 1945, edhe për një arsye tjetër, që kishte të bënte me pretendimet e pajustificuara territoriale të Jugosllavisë së re ndaj vendeve fqinje, realizimi i të cilave do të çonte në krijimin e një shteti të madh jugosllav, që do të dominonte Ballkanin e më gjerë.³²

Shumica e shqiptarëve e dëshironin bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, por gradualisht zërat e atyre që flisnin hapur për këtë çështje po shuheshin. Njerëzit që shpreheshin hapur për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë vinin kryesisht nga radhët e kundërshtarëve politikë të regjimit komunist, nga të akuzuar e dënuar për krime lufte, të larguar në male si kundërshtarë të regjimit të ri dhe përgjithësisht nga krahu nacionalistë. Ndjeshmëri e lartë për Kosovën vihej re tek popullsia e

²⁹ *Po aty*.

³⁰ TNA, HS. MO1. COLL 64/5, tepër sekret, 6 dhjetor 1944.

³¹ A. Lalaj, *Dosjet e Luftës...*, f. 382.

³² Sh. Vukaj, *Rusia dhe Kosova (shënime të një diplomati)...*, f. 74-75.

zonave veriore të vendit, në kufi me Kosovën, të cilët ishin privuar nga disa liri e të drejta, që i kishin pasur gjatë kohës së luftës, kur Kosova ishte e bashkuar me Shqipërinë. Të pakënaqur me regjimin komunist të vendosur në Kosovë ishin edhe mësuesit shqiptarë të dërguar në këtë krahinë gjatë periudhës së luftës, shumica e të cilëve u kthyen në Shqipëri.

Shqetësime e pakënaqësi për trajtimin e çështjes së Kosovës, ishin vënë re edhe tek krahu i majtë opozitarë, brenda radhëve të Frontit Demokratik të Shqipërisë, si Gjergj Kokoshi, Mirash Ivanaj, Selaudin Toto, Shefqet Beja etj, të cilët e shihnin çështjen e Kosovës, si një pikë të dobët të programit të qeverisë shqiptare. Kokoshi gjykonte se, Shqipëria nuk duhej që ta lidhte fatin e vet me atë të Jugosllavisë, sepse me shpërbërjen e pritshme të saj, do të ç'bëhej Shqipëria dhe pavarësia e saj. Personat e lartpërmendur e mirëkuptonin politikën e qeverisë shqiptare, për të mos e kërkuar Kosovën përpara mbajtjes së Konferencës së Paqes, por donin që ajo të shprehej për perspektivën e shqiptarëve në Jugosllavi.³³

E vetmja zgjidhje e mundshme për Kosovën pas mbarimit të LDB, mund të arrihej përmes vullnetit dhe mirëkuptimit të PKJ dhe PKS, mbështetjes nga Bashkimi Sovjetik dhe krijimit të rrethanave të favorshme ndërkombëtare. Udhëheqja komuniste e Shqipërisë së paku që nga tetori i vitit 1944, ishte pajtuar në heshtje me ribashkimin e Kosovës me Jugosllavinë, ndonëse zyrtarisht nuk kishte hequr dorë prej saj. Ajo u tregua shumë e rezervuar për të kërkuar bashkimin e Kosovës me Shqipërinë si gjatë LDB ashtu edhe menjëherë pas mbarimit të saj. "Pikëpamjet tona, ka shkruar Enver Hoxha, kanë qenë se, ne nuk mund të ngrinin çështjen e Kosovës për bashkimin e saj me Shqipërinë gjatë kohës së Luftës, por shqiptarët e Kosovës duhej të luftonin kundra fashizmit në kuadrin e Jugosllavisë, dhe mbas fitores kjo çështje do të zgjidhej nga të dy partitë komuniste motra dhe, regjimet demokratike popullore që do të vendoseshin në Shqipëri dhe në Jugosllavi. Në pragun e çlirimit të Jugosllavisë dhe Shqipërisë, shkruan ai më tej, përsëri ne kemi menduar se, nuk mundej ta shtronim çështjen e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, pse ishim përpara detyrave të forcimit e

³³ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1944-1948 ...*, vëll. I, f. 157-158. Raport i përfaqësuesit diplomatik të Jugosllavisë në Tiranë, Josip Gjergja, drejtuar MPJ të Jugosllavisë, 12 dhjetor 1945, shih: AJ, 507, IX, 1/II-47.

konsolidimit të pushteteve tona demokratike popullore”.³⁴ Enver Hoxha është përpjekur që ta argumentojë heshtjen e mbajtur nga PKSH për Kosovën edhe me situatën e vështirë ndërkombëtare dhe rrezikun që kjo paraqiste për sigurinë e vendit nga ndonjë sulm i mundshëm i ‘vendeve imperialiste’. “Kosova, ka shkruar ai, ishte më pak në rrezik duke qëndruar në kohët e para e bashkuar me Jugosllavinë”.³⁵

Situatën e paqartë në lidhje me çështjen e Kosovës e dëshmojnë qartazi deklaratat e Omer Nishanit dhe Koço Tashkos, të shprehura në takimet private e zyrtare me pjesëtarë të Misionit Ushtarak Amerikan në Shqipëri. Ministri i Jashtëm i Qeverisë së Përkohshme Demokratike të Shqipërisë, Omer Nishani dhe sekretari i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, Koço Tashko, në shkurt 1945, kishin paraqitur deklarata kontradiktore në lidhje me të ardhmen e Kosovës. I pari ishte shprehur se, Kosova do të ishte një shtet i veçantë autonom brenda Jugosllavisë Federative, ndërsa i dyti, mbronte versionin se, ende nuk ishte arritur ndonjë marrëveshje për Kosovën, dhe se problemi i saj ishte shtyrë deri në çlirimin e Jugosllavisë dhe rënien e Gjermanisë.³⁶ Stephen Peters komentonte se, që të dy personat e mësipërm thjesht supozonin, sepse tashmë “Kosova nuk është një shtet autonom, por pjesë e Serbisë dhe Maqedonisë Federale”.³⁷ Gazeta ‘Bashkimi’ në vitin 1945 publikonte artikuj mbi ‘lirinë’ e shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në çështjet civile lokale.

Për dëshirën e shqiptarëve për bashkim me Kosovën, flet një incident i ndodhur në Tiranë, në mbledhjen e Frontit Nacionalçlirimtar (FNÇ), në javën e fundit të qershorit 1945. Përfaqësuesi i krahinës së Kukësit në FNÇ, në fjalën e tij kishte shprehur pakënaqësinë e popullsisë

³⁴ *AQSH*, F. 14/AP, V. 1949, D. 1, Lista 3, fl. 2-3. Letër e Enver Hoxhës drejtuar KQ të PK(b)BRSS në emër të KQ të PKSH; Enver Hoxha, *Ditar për çështje ndërkombëtare (1966-1967)*, vëll. 4, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH, Tiranë: 1982, f. 216.

³⁵ *AQSH*, F. 14/AP, V. 1949, D. 1, Lista 3, fl. 4. Letër e Enver Hoxhës drejtuar KQ të PK(b)BRSS në emër të KQ të PKSH. Dokumentet e arkivave amerikane e britanike nuk të çojnë në konkluzionin se Shqipëria në vitin 1945-1946 ishte e kërcënuar nga ndonjë sulm imperialist, sikurse shkruan E. Hoxha. Në këtë kohë në Shqipëri gjendeshin misionet civile e ushtarake të Britanisë së Madhe, SHBA e Francës, relacionet e të cilëve favorizonin njohjen e qeverisë shqiptare.

³⁶ *NARA*, RG 226, Entry 16, File 130063, f. 1. Raport nr. 16 i Stephen Peters “Albanian Views on Kosovo” (Vështrime shqiptare për Kosovën), Tiranë, 19 maj 1945.

³⁷ *Po aty*.

së saj, për zgjidhjen e pafavorshme të çështjes së Kosovës. Por, diskutimi i tij ishte ndërprerë, nga ndërhyrja e ashpër e Sejfulla Malëshovës, i cili e konsideronte problemin e Kosovës ‘çështje të qeverisë dhe jo të Frontit’. Sidoqoftë, fjala e delegatit të Kukësit ishte pritur me gëzim nga përfaqësuesit e tjerë, të cilët nga frika nuk kishin guxuar që ta mbështetnin atë publikisht.³⁸

Në Plenumin IV të Komitetit Qendror të PKSH-së, mbajtur më 17 tetor 1945, Hoxha shprehej: ‘Partia e jonë e ka çfaqur pikëpamjen e saj karshi Kosovës. Për Partinë kjo nuk është kritike, por me qenë se e ngre opozita ka rëndësi. Cili është qëndrimi ynë para popullit? Po ai i mëparshmi. Perspektiva e largët është që Kosova do të lidhet me ne. Kosova është shqiptare këtë e dimë edhe ne edhe Jugosllavia. Në rast se opozita do ta ngre këtë çështje, ne do të na duhet që të mbajmë një qëndrim edhe me shkrim, por gjithmonë ky do të jetë qëndrimi i ynë’.³⁹

Udhëheqja komuniste e Shqipërisë e shihte Jugosllavinë si vendin model për zhvillimin e Shqipërisë në rrugën e ‘demokracive popullore, si mbështetësen e saj për ruajtjen e pushtetit brenda vendit dhe, si mbrojtësen e saj në arenën ndërkombëtare dhe në veçanti nga pretendimet greke për Shqipërinë e Jugut. Shqipëria, deri në mesin e vitit 1948 e zbatoi modelin sovjetik të zhvillimit, nën asistencën dhe kujdesin e veçantë të Jugosllavisë së Titos dhe të eksperiencës së saj.⁴⁰ Beogradi ishte për Tiranën, një qendër jo më pak e rëndësishme, në mos më e rëndësishme se sa ishte Moska për vetë Jugosllavinë dhe vendet e tjera të Evropës Lindore [të quajtura] ‘Demokraci Popullore’.⁴¹

³⁸ *Po aty*, RG 226. Raport i Stephen Peters që i përcillet dr. William L. Langer (drejtor i Research and Analysis - R&A) Washington D.C., 7 korrik 1945.

³⁹ *AQSH*, F. 14/AP, V. 1945, D. 2, fl. 101. Diskutim i Enver Hoxhës në Plenumin IV, tetor 1945, cituar sipas S. Sylas, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës...*, f. 107.

⁴⁰ *AQSH*, F. 14/AP, V. 1945, D. 6, Lista 1, fl. 1. Letër e Naxhije Dumes drejtuar udhëheqjes së lartë të PKSH nga Beogradi, 30 mars 1945. Udhëheqja jugosllave në marsin e vitit 1945 i rekomandonte PKSH që të shkarkonte Omer Nishanin nga posti i ministrit të Jashtëm, ndërsa e quante të papranueshëm zëvendësimin e tij me Ymer Dishnicën, për shkak të kompromisit të bërë prej tij në Konferencën e Mukjes. Rankoviçi nuk ishte dakord me propozimin e palës shqiptare, që Shefqet Beja të emërohej ministër i Tregtisë, sepse ai konsiderohej si ‘element i lëkundur’. Përkundrazi, Rankoviçi e mbështeste kandidaturën e Sejfulla Malëshovës, për t’u emëruar zëvendëskryeministër i Shqipërisë.

⁴¹ L. Gibianskii, “The Beginning of the Soviet-Yugoslav Conflict...”, f. 470.

Jugosllavët kontrollonin pothuajse gjithçka në Shqipëri, jetën politike dhe organizative të PKSH, qeverinë, ekonominë, ushtrinë, shërbimin informativ dhe politikën e jashtme të shtetit shqiptar. Emërimet e ministrave dhe funksionarëve të tjerë të lartë në Shqipëri, kalonin përmes ‘sitës’ së PKJ dhe qeverisë jugosllave.⁴² Nga fundi i vitit 1944 dhe gjatë vitit 1945, shumica e udhëheqësve kryesorë të shtetit dhe PKSH kishin vizituar Jugosllavinë dhe, kishin sjellë eksperiencën e saj, në ndërtimin dhe organizimin e partisë e të shtetit shqiptar. Emisarë të lartë, të dërguar nga PKJ kontrollonin PKSH dhe shtetin shqiptar. Vendosija e PKSH nën siglën e Frontit Demokratik në vitet 1945-1948, ishte gjithashtu eksperiencë e huazuar nga Jugosllavia.⁴³

Në shkurt 1945, një delegacion shqiptar i kryesuar nga dr. Omer Nishani, në përbërje të të cilit ishin edhe gjeneral Myslim Peza, gjeneral Bedri Spahiu dhe Nako Spiro, vizitoi Beogradin. Delegacioni nuk u fokusua tek problemet ushtarake, sikurse ishte paraparë, por tek çështje të tilla si, rimëkëmbja e Shqipërisë, perspektivat dhe modeli i zhvillimit të saj në të ardhmen etj. “Në lidhje me këto detyra, u mbajtën disa takime me shokun Tito, Kardelin, Gjilasin, Rankoviçin, Vujasinoviçin, Nikolla Petroviçin etj., të cilët ofruan ndihmë të madhe në lidhje me organizimin e sektorëve të caktuar sipas modelit të Jugosllavisë”.⁴⁴ Produkt i kësaj vizite ishte nënshkrimi në shkurt 1945, i ‘Traktatit mbi Aleancën dhe Ndihmën Mutuale’ ndërmjet të dy vendeve, pika 6 e të cilit fliste për mbrojtje reciproke dhe respekt të plotë të minoriteteve nacionale, duke nënkuptuar kështu edhe Kosovën, për të cilën nuk flitej asnjë fjalë.⁴⁵

Shteti shqiptar jo vetëm që heshti përballë dhunës dhe terrorit të ushtruar nga Jugosllavia në Kosovë, por në disa raste Drejtoria e

⁴² AQSH, F. 14/AP, V. 1945, D. 6, Lista 1, fl. 1-2. Letër e Naxhije Dumes drejtuar udhëheqjes së lartë të Partisë, Beograd, 30 mars 1945.

⁴³ Leonid Gibianskii, “The 1948, Soviet-Yugoslav Clash: Historiographical versus and new archival sources”, in *Yugoslavia in the Cold War*, Institut of Contemporary History of Ljubljana and University of Toronto, Ljubljana: 2004, f. 57.

⁴⁴ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1944-1948...*, vëll. I, f. 74-75. Raport i Vojo Todoroviç-it, shkurt 1945, AJ. 507, IX, 1/I.

⁴⁵ AMPJ, V. 1945, D. 50, fl. 1-4. Traktati u firmos në Beograd nga mareshal J.B. Tito me cilësinë e Presidentit të Komitetit Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë dhe ministri i Punëve të Jashtme Dr. Josip Smodlaka, si dhe nga delegacioni shqiptar prej 4 vetash, i kryesuar nga zëvendëskryeministri i Qeverisë Demokratike të Shqipërisë Myslym Peza. Traktati nuk hyri në fuqi sepse u kundërshtua nga Stalini, më 9 janar 1945, në takimin me delegacionin jugosllav në Moskë, të kryesuar nga Hebrang-u.

Mbrojtjes së Popullit (më pas: Sigurimi i Shtetit) bashkëpunoi me OZN-ën, për të kapur e dënuar shqiptarë të arratisur nga Kosova në Shqipëri dhe anasjelltas. Oficerë të OZN-ës u lejuan nga qeveria shqiptare në fillim të vitit 1945, që të kalonin kufirin dhe të pushkatonin ilegalisht dhe pa gjyq më tepër se 1000 shqiptarë nga Kosova.⁴⁶ Njerëz të OZN-ës ishin lejuar gjithashtu, që të futeshin në territorin e shtetit shqiptar dhe të dorëzonin persona, të akuzuar nga organet e drejtësisë shqiptare. Kjo praktikë u kundërshtua nga Velimir Stojniçi, i cili mendonte se dorëzimi i tyre tek autoritetet shqiptare, duhej të kryhej, vetëm pasi ata të ishin verifikuar më parë nga Komisioni përkatës i Jugosllavisë.⁴⁷

Kosova në vitet e miqësisë dhe ndarjes së Shqipërisë me Jugosllavinë, qershor 1946-qershor 1948

Megjithëse udhëheqja shqiptare për gati një vit e gjysmë qëndroi në heshtje për çështjen e Kosovës, dyshimet e udhëheqjes jugosllave nuk u shuan. Josip Gjergja, më 7 shkurt 1946 i shkruante Titos nga Tirana: “Udhëheqja, përkatësisht E. Hoxha, Xoxe dhe rrethet e tyre, posedojnë një dozë të caktuar mosbesimi të fshehur ndaj Jugosllavisë, ose e thënë më mirë, ekziston një frikë e caktuar në pikëpamjen e planeve [jugosllave] ndaj Shqipërisë. Kjo vërehet sidomos në popullarizimin e suksesit të politikës së Jugosllavisë [në Shqipëri]. Në përpjekje për ta fshehur atë [udhëheqja shqiptare] është e detyruar të shkojë pothuajse tërësisht në krah të Jugosllavisë dhe, të mësojë nga ajo. Nga ana tjetër, nënvizonte Gjergja, pas ardhjes së Çuvahinit*, vihet re favorizimi i BRSS, ndërsa shtypi flet për vendosjen e lidhjeve dhe kontakteve të drejtpërdrejta, dhe ato në dëmin tonë. Mund të arrihet në konkluzionin, shkruante ai, se me përqaftimin e ngushtë me BRSS, [ata përpiqen] të shmangin rrezikun nga Jugosllavia”.⁴⁸

⁴⁶ AMPJ, V. 1949, D. 191(B/ V-2), fl. 43, cituar sipas S. Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës...*, f. 115.

⁴⁷ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1944-1948...*, vëll. I, f. 92, AJ.507, IX, 1/I-16, lista 1, 29.VI.1945.

* Dimitri S. Çuvahin ishte ministër Fuqiplotë i BRSS në Shqipëri. Ai mbërriti në Tiranë më 10 janar 1946.

⁴⁸ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1944-1948...*, vëll. I, f. 181. Letër e Josip Gjergjas drejtuar J.B. Titos nga Tirana, 7 shkurt 1946.

Pavarësisht nga dyshimet e lartpërmendura, Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe, më 26 shkurt 1946 i kërkuan Josip Gjergjas, që marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve të ngriheshin në nivel më të lartë. Hapin e parë të rëndësishëm do ta shënonte nënshkrimi i Traktatit të Miqësisë dhe Ndhimës Reciproke, në thelb një aleancë politike ndërmjet dy vendeve më 9 korrik 1946. Për arritjen e tij nuk kishte pengesa parimore, sikurse kishin Bullgaria, Rumania dhe Hungaria, që si vende humbëse që ishin, duhej të prisnin derisa të ratifikonin Traktatet e Paqes. Deri në këtë kohë, Jugosllavia kishte nënshkruar Traktate Miqësie dhe Ndhime Reciproke me BS (11 prill 1945), me Poloninë (16 mars 1946) dhe me Çekoslllovakinë (9 maj 1946).⁴⁹ Traktati i Miqësisë dhe Ndhimës Reciproke me Jugosllavinë ishte i pari traktat politik bilateral, që Shqipëria do të nënshkruante me një vend të ‘Demokracive Popullore’. Ai do t’i hapte rrugë nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera me Jugosllavinë, kulmin e të cilave e shënoi Konventa Ekonomike e 26 nëntorit 1946.*

Më 4 mars u dërgua në Beograd një delegacion shqiptar i kryesuar nga ministri i Ekonomisë dhe kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit Nako Spiru, të cilin Josip Gjergja e cilësonte si “mik i njohur i Legatës dhe i Jugosllavisë dhe, kohët e fundit luftëtar kryesor i kësaj politike të shëndoshë”.⁵⁰ Nako Spiru mori takime me udhëheqësit më të lartë të Jugosllavisë, si Kardelin, Rankoviçin, Jugoviçin etj., si dhe me ambasadorin e BS në Beograd, A. J. Llavrentjevin. Në prill 1946, në prag të nisjes së delegacionit jugosllav për në Moskë, Tito u takua me ambasadorin sovjetik në Beograd – Llavrentjevin. “Nga biseda me Titon, ka shënuar në ditarin e tij ambasadori sovjetik, kuptohej se në fund të fundit, Shqipëria duhej të përfshihej në përbërje të Federatës Jugosllave”.⁵¹

⁴⁹ Zbigniew K. Brzezinski, *The Soviet Bloc, Unity and Conflict*, 2nd edition, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts: 1967, f. 109.

* Konventa ekonomike përfshinte: koordinimin e planeve ekonomike; bashkimin doganor ndërmjet dy vendeve; unifikimin (parifikimin) e monedhës, krijimin e shoqërive të përbashkëta etj.

⁵⁰ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1944-1948...*, vëll. I, f. 187. Letër e Josip Gjergjas për J.B. Titon, 4 mars 1946, AJ, F. 507, IX, 1/I-48, listova 1, 04.03.1946.

⁵¹ *Sovjetskij Faktor v Vostočnoj Evrope, 1944-1953*, Tom I, 1944-1948, Rosijskij Akademija Nauk, Moskva: Rosspen, 1999, f. 281.

Vizita e delegacionit shqiptar të nivelit të lartë në Jugosllavi, e kryesuar nga kryeministri Enver Hoxha u parashikua të zhvillohej në mesin e muajit prill, por u realizua në javën e fundit të muajit qershor.⁵² Pavarësisht nga dëshirat e udhëheqjeve të dy vendeve, vendimi përfundimtar për nënshkrimin e Traktatit të Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke do të merrej në Moskë, nga Stalini, në takimin e tij të fundit me Titon, më 27 maj 1946.⁵³ Në takim, krahas të tjerave, Stalini foli edhe për përfshirjen e Shqipërisë në të ardhmen, në “përbërje të Jugosllavisë Federative”, por “në fillim, do të nënvizonte ai, duhet diskutuar çështja mbi miqësinë dhe ndihmën reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë”.⁵⁴ Megjithëse udhëheqja sovjetike i kishte lënë ‘dorë të lirë’ veprimtarisë së Jugosllavisë në Shqipëri, Stalini i vëzhgonte me kujdes marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe ruante të drejtën e ‘fjalës së fundit’ për çështjet madhore, sikurse ishte Traktati i Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke, problemi i Federatës Ballkanike etj.⁵⁵ Koha e zgjedhur për nënshkrimin e këtij Traktati u konsiderua nga Tito, si mjaft e favorshme, për shkak të fillimit të shpejti të Konferencës së Paqes të Parisit.⁵⁶

Gjatë bisedimeve të Beogradit (3 qershor – 2 korrik 1946), me nxitjen e Titos, u diskutua edhe për problemin e Kosovës.⁵⁷ Ende nuk e njohim të plotë procesverbalin e takimit të Enver Hoxhës me Titon, por, për këtë ngjarje kemi dy dëshmi të rëndësishme, të nxjerra nga arkivat ruse, *së pari*, takimin e Enver Hoxhës me Çuvahin-in, menjëherë pas kthimit të tij nga Beogradi, më 3 korrik dhe *së dyti*, bisedën e Josip Gjergjas me Çuvahin-in më 5 korrik. Enver Hoxha ka shkruar gjithashtu

⁵² AQSH, F. 14/AP, V. 1946, D. 11.

⁵³ *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse, 1946-1962 ...*, f. 24-25. Shih procesverbalin e regjistrimit sovjetik të takimit, në: APRF, F. 45, Op. 1, D. 397, L. 107-110.

⁵⁴ *Po aty*.

⁵⁵ *Vostočnaja Evropa v Dokumentah Rossijskih Arhivov, 1944-1953*, Tom I, 1944-1948, Rossijskaja Akademia Nauk, Moskva: Novosibirsk, 1997, f. 474. Nga biseda e Enver Hoxhës me D.S. Çuvahin-in, 3 korrik 1946.

⁵⁶ AQSH, F. 14/AP, V. 1946, D. 9, Lista nr. 2, fl. 1. Radiogram i Hysni Kapos dërguar Enver Hoxhës nga Beogradi, 19 qershor 1946. Delegacioni jugosllav në Konferencën e Paqes së Parisit kishte në përbërje rreth 100 veta, ndërsa ai i BS dyfishin e tij.

⁵⁷ E. Hoxha, *Titistët...*, f. 259-260. “...Titoja më pyeti ç’mendoja unë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi. Heshta një moment për t’i përmbledhur në mënyrë sa më koncize e të plotë pikëpamjet tona për këtë problem të rëndësishëm....”.

për këtë ngjarje në librat e tij me kujtime të botuara në fillim të viteve 80-të.⁵⁸ Diplomati sovjetik ka shënuar në ditarin e tij, fjalët që Enver Hoxha i kishte thënë Titos në lidhje me Kosovën. “Enver Hoxha, shkruan ai, mendonte se çështja e Kosovës dhe e Metohisë, duhej që në një farë mënyre të zinte vend në Traktatin e Miqësisë dhe të Ndihmës Reciproke. Nëse kjo nuk do të bëhej, elementët reaksionarë në Kosovë e Metohi dhe po ashtu edhe në Shqipëri, do të bëjnë propagandë të madhe, duke shpallur se qeveria e tanishme shqiptare po ia shet këto krahina Jugosllavisë”.⁵⁹ Tito e pranoi parimisht, të drejtën e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, e cila herët apo vonë do t’i kthehet asaj, por e konsideroi atë të parakohshme. Ai gjykonte se, “as situata e brendshme në Jugosllavi dhe as situata ndërkombëtare në përgjithësi, nuk e favorizojnë ngritjen e çështjes së bashkimit të këtyre krahinave me Shqipërinë”.⁶⁰ Tito ofroi si rrugëzgjdhje të shpejtë hapjen e kufirit jugosllavo-shqiptar, me qëllim që shqiptarët e të dy anëve të lëviznin lirisht ndërmjet tyre, por Enver Hoxha shfaqti mendimin, se ky problem kërkonte një studim të posaçëm dhe se kësaj çështjeje do t’i ktheheshin më vonë.⁶¹

E ardhmja e Kosovës, sipas Titos, do të zgjidhej ‘brenda Federatës Ballkanike’, ku bashkimi i saj me Shqipërinë do të ishte më i lehtë, ndërkohë që “në të vërtetë, ka shkruar Enver Hoxha, mendimi i tij ishte që Shqipëria të lidhej me Kosovën dhe, tok me të, të gllabëroheshin në Jugosllavinë titiste”.⁶² Mënyra se si u shtrua çështja e Kosovës nga Enver Hoxha nuk la shije të mirë tek ministri jugosllav në Tiranë, Josip Gjergja. “Enver Hoxha, do ti kumtonte ai Çuvahinit, e shtroi në mënyrë të papërshtatshme çështjen e Kosovës dhe të Metohisë..., duke bërë vërejtje të mëdha”.⁶³

Shqetësimet e udhëheqjes jugosllave për të ardhmen e Kosovës dhe afrimin e kohëve të fundit të Shqipërisë me BS, u diskutuan më 30 maj 1947, në takimin e ministrave Fuqiplotë të Shqipërisë e Jugosllavisë në

⁵⁸ *Po aty*, f. 259-264.

⁵⁹ *Vostočnaja Evropa v Dokumentah Rossijskih Arhivov ...*, Tom I, f. 476.

⁶⁰ *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse, 1946-1962...*, f. 31. Nga biseda e D. S. Çuvahin-it me Josip Gjergjan, Tiranë, 5 korrik 1946, CF VE, T.I. AVP RF, F. 06, Op. 8, P. 22, D. 319, L. 30-33. Josip Gjergja ishte dëshmitar okular i takimit, sepse ai shërbeu si përkthyes i bisedës së Tito-s me Enver Hoxhën.

⁶¹ *Vostočnaja Evropa v Dokumentah Rossijskih Arhivov ...*, Tom I, f. 477.

⁶² E. Hoxha, *Titistët...*, f. 261-263.

⁶³ *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse, 1946-1962...*, f. 31. Nga biseda e D.S. Çuvahin-it me Josip Gjergjan, Tiranë, 5 korrik 1946.

Moskë - Mihal Priftit dhe V. L. Popoviçit.⁶⁴ Ministri jugosllav shfaqti dyshime të forta për ‘marrëveshjet’ që, sipas tij, kishte arritur të ‘nënshkruante’ Nako Spiru me qeverinë sovjetike.⁶⁵ Përfaqësuesi diplomatik i Jugosllavisë u përpoq të njihej me opinionin ‘personal’ të Mihal Priftit për këto dy çështje. Përgjigjja e Mihal Priftit se, parullat e reaksionit nuk gjenin më jehonë në popull dhe, se vëmendja e tij ishte drejtuar tek situata e krijuar nga provokacionet greke në jug të vendit, duket se e kënaqi diplomatin jugosllav. Përkundrazi, fjalët e mëtejshme e tij se, “pikëpamja ime personale mbi t’ ardhmen e Kosovës është ajo e Qeverisë s’ime dhe e Partisë s’ime” u prit me shumë rezerva. Popoviçi e mendonte të ardhmen e Kosovës të bashkuar me Shqipërinë, por në kuadrin e një Federate apo Konfederate Ballkanike. Vërejtja e Mihal Priftit se, “në vendin tonë nuk flitet e nuk përmendet fare konfederata ballkanike” e nervozoi diplomatin jugosllav, i cili artikuloi kritika të forta në adresë të udhëheqjes shqiptare, për afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, pa marrë më parë miratimin e udhëheqjes jugosllave. “Juve e dini, u shpreh Popoviçi, se vendet t’ona janë lidhur me një traktat të gjerë ekonomik. Neve nuk e kuptojmë se si në një kohë kur jemi kështu të lidhur ekonomikisht, juve të kërkonti të bëni të tjera marrëveshje ekonomike dhe tregtare me vende të tjerë, neve nuk mund të kuptojmë se si pa u konsultuar me neve, pa u marrë vesh më përpara me neve, juve të bëni të tilla veprime”.⁶⁶ Vajtja e Nako Spiru në Moskë dhe vendosja e lidhjeve direkte ndërmjet Shqipërisë dhe BS u panë me dyshim nga udhëheqja jugosllave, e cila e konsideroi atë si rrezik potencial dhe si kundërpeshë ndaj rolit të saj prej gardiani në Shqipëri.⁶⁷ Udhëheqja jugosllave ishte e pakënaqur me mënyrën dhe me ritmin se si po zhvilloheshin marrëdhëniet ekonomike me Shqipërinë dhe raportet e kësaj të fundit me BS, ndërkohë që shteti jugosllav në vitet e para të pasluftë, nënshkroi marrëveshje të shumta jo vetëm me BS dhe vendet e

⁶⁴ AMPJ, V. 1947, D. 106-B/I-4, fl. 2-3. Relacion i Mihal Priftit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Moskë, 5 qershor 1947; shih edhe S. Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës...*, f. 131-132.

⁶⁵ Nako Spiru vizitoi Moskën më 26 prill-27 maj 1947, në prag të vajtjes së delegacionit të lartë shqiptar të kryesuar nga Enver Hoxha. Shih: AQSH, F. 14/AP, V. 1947, D. 16, L. 1.

⁶⁶ AMPJ, V. 1947, D. 106-B/I-4, fl. 2. Relacion i Mihal Priftit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Moskë, 5 qershor 1947.

⁶⁷ L. Gibianskii, “The Beginning of the Soviet-Yugoslav Conflict...”, f. 471, AJBT-KMJ, 1-3-b/651, 1, 1-5; ASSIP-PA, 1947 god., F-IV, Str.Pov. 1765.

‘Demokracive Popullore’, por edhe me disa vende të Evropës Perëndimore, pa pyetur dhe pa u konsultuar me udhëheqjen e shqiptare. Udhëheqja jugosllave, ka shkruar historiani rus Leonid Gibianskii “u ndje më e pavarur se sa ndonjë regjim tjetër komunist i Evropës Lindore, madje i lejo vetes që të kundërshtonte në një masë të caktuar vendimet e sovjetikëve, nëse ato ishin veçanërisht të dëmshme për interesat e Beogradit”.⁶⁸ E pakënaqur me zbatimin e marrëveshjeve ekonomike me Jugosllavinë ishte edhe udhëheqja shqiptare. Enver Hoxha, më 15 korrik 1947, gjatë bisedës që zhvilloi me Molotov-in në Moskë i bëri të ditur se, pala jugosllave ishte e painteresuar që të përmbushte detyrimet e saj ekonomike, që rridhnin nga marrëveshjet e firmosura ndërmjet dy vendeve.⁶⁹

Problemi i Kosovës, sipas dokumenteve të njohura,⁷⁰ nuk u diskutua gjatë vizitës që delegacioni shqiptar i kryesuar nga Hoxha bëri në Moskë, më 14-26 korrik 1947 dhe takimeve që ai pati me Stalinin dhe udhëheqësit e tjerë të lartë të Partisë dhe shtetit sovjetik. Stalini e këshilloi delegacionin shqiptar, që Shqipëria të vazhdonte edhe më tej të mbështetej tek Jugosllavia, ndërsa ndihmat sovjetike do të vazhdonin të jepeshin jo drejtpërdrejt, por përmes saj, ‘për shkak të pengesave që mund të sillnin anglo-amerikanët’.⁷¹ Në thelb, i njëjti mesazh i ishte

⁶⁸ Po aty, f. 469.

⁶⁹ *Vostočnaja Evropa v Rossijskih Arhivov ...*, Tom I, f. 679-680. Nga ditari i V. M. Molotov-it.

⁷⁰ AQSH, F. 14/AP, V. 1947, D. 1, Lista 1. Marrëdhëniet me Partinë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik; po aty, F. 14/AP, V. 1947, D. 23, Lista 1. Procesverbal i Mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH, 27 korrik 1947; po aty, F. 14/AP, V. 1947, D. 1, Lista 1. Plenumi i 7 i KQ të PKSH, korrik 1947.

⁷¹ Po aty, F. 14/AP, V. 1947, D.1, Lista 1, fl. 4, 4/1. Plenumi i 7 i KQ të PKSH, korrik 1947, shih: Çështja e marrëdhënieve me Jugosllavinë. Stalini në më shumë se një herë ka folur për reagimin e mundshëm të anglo-amerikanëve, nëse Shqipëria do të afrohej më shumë me BS. Duhet përmendur se, Shqipëria ishte ndër të rrallat vende të Bllokut Komunist, e cila nuk arriti që të nënshkruante një traktat bilateral ndihme e miqësie reciproke me BS, sikurse vendet e tjerë të Bllokut Komunist [përveç Gjermanisë Lindore], duke përfshirë edhe vendet humbëse të luftës, sikurse ishin Bullgaria, Hungaria e Rumania. Këto tri vende nënshkruan traktate të kësaj natyre me BS në fillim të vitit 1948, pasi kishin ratifikuar më parë Traktatet e Paqes. Për më shumë shih: Z. Brzezinski, *Soviet Bloc, Unity and Conflict...*, f. 109-110. Në maj 1955 Shqipëria u bë pjesë e Traktatit të Varshavës, i cili shënonte të parin traktat shumëpalësh të vendeve të Bllokut Komunist dhe të parin instrument të angazhimit zyrtar të BS dhe të vendeve të tjera anëtare të tij në mbrojtje të Shqipërisë.

transmetuar Enver Hoxhës në korrik 1946, në takimin e tij me ministrin e jashtëm të BS-Molotovin, në Konferencën e Paqes të Parisit. “Në mes të BRSS dhe Shqipërisë, ishte shprehur Molotovi, qëndron Jugosllavia. Shqipëria duhet të vendosë marrëdhënie së më të ngushta, në radhë të parë me Jugosllavinë”.⁷² Sidoqoftë rezervat dhe dyshimet e Titos ndaj pozicionit të BS ndaj Shqipërisë nuk ishin shuar. Lavrentjevi i raportonte Moskës për një takim që kishte zhvilluar në gusht 1947 me Tito-n në Beograd, i cili ishte shprehur se “ndihma e BS për Shqipërinë nuk duhet të konsiderohet si shfaqje e asaj, që BS dëshiron që ta ndajë Shqipërinë nga Jugosllavia, por përkundrazi, si mbështetje për afrimin e mëtejshëm të dy vendeve fqinje”.⁷³

Në ato rrethana, udhëheqja jugosllave reagoi me forcë dhe ushtri presion mbi udhëheqjen e PKS H dhe njëkohësisht, shqetësimet e saj vazhdoi t’ia paraqiste udhëheqjes sovjetike dhe Stalinit. Më 9 tetor 1947, Josip Gjergja njoftonte Titon nga Tirana, se specialistët rusë po tërhiqeshin nga Shqipëria, për shkak të orientimit ekonomik në rritje të Shqipërisë drejt Jugosllavisë. Tërheqjen e tyre, ai e konsideronte si hap normal, që buronte nga pozicioni i veçantë që kishte fituar Jugosllavia në Shqipëri, rol i cili ishte njohur edhe nga BS.⁷⁴

Presioni i Jugosllavisë mbi Shqipërinë u shtua veçanërisht në fund të vitit 1947 dhe në muajt e parë të vitit 1948. Situata u tensionua në nëntor 1947, pas letrës së dytë që PKJ i dërgoi PKS H dhe, akuzave të rënda që ajo lëshoi në adresë të udhëheqjes shqiptare dhe veçanërisht të Nako Spirut, i cili u vetëvra në rrethana të rënduara.⁷⁵ Udhëheqja

⁷² *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1944-1948...*, vëll. I, f. 327. Raport i Savo Sllatiç (përfaqësues i KQ të PKJ pranë KQ të PKS H) mbi takimin e tij me Enver Hoxhën, 13 shtator 1946.

⁷³ *Vostočnaja Evropa v Rossijskih Arhivov ...*, Tom I, f. 687. Nga ditari i A. I. Lavrentjev-it, “Biseda me Titon mbi fërkimet shqiptaro-jugosllave”, 14-15 gusht 1947, ABP, RF. F. 06, Op. 9, P. 82, D. 1285, l. 110-112.

⁷⁴ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1944-1948...*, vëll. I, f. 348, sipas: AJ, F. 507, IX, 1/I,-102, br. Listova 1.

⁷⁵ Në mbledhjen e Byrosë Politike u miratuan akuzat e PKJ, të cilat e rënduan shumë pozitën e Nako Spirut, i cili kreu vetëvrasje, pasi nuk gjeti mbështetje as tek Enver Hoxha, as tek Byroja Politike, dhe as tek sekretari i parë i Misionit Sovjetik në Tiranë – Gagarinov, i cili zëvendësonte përkohësisht Çuvahin-in. Duket se udhëheqja e lartë sovjetike nuk dëshironte që të hynte në konflikt të parakohshëm me Jugosllavinë, në kohën kur mosmarrëveshjet ishin ende në fazën latente. Sipas autores ruse, Nina Smirnova, Nako Spiru pas mbledhjes së Byrosë Politike i dorëzoi Gagarinov-it një letër, me tezat e fjalës që ai do të mbante në mbledhjen e ardhshme të Byrosë Politike

shqiptare u akuzua se brenda saj ishin krijuar dy vija, një projugosllave dhe një tjetër kundër saj, prapa së cilës aludohej se qëndronte BS. Dy ministrat e Jugosllavisë në Moskë e Tiranë (V. Popoviç e Josip Gjergja), kanë shfaqur dyshime e aludime për lidhjet e Nako Spirut me Çuvahin-in dhe sidomos me A. N. Gagarinov-in.⁷⁶

Më 5 dhjetor 1947, Savo Sllatiçi i përcolli Enver Hoxhës udhëzimet e KQ të PKJ për gjendjen aktuale të marrëdhënieve dypalëshe dhe të ardhmen e tyre.⁷⁷ Dy ditë më pas ato u diskutuan në mbledhjen e Byrosë Politike të PKSH.⁷⁸ Thelbi i kërkesave jugosllave kishte të bënte me bashkimin ekonomik të Shqipërisë me Jugosllavinë, si hap i parë dhe më i rëndësishëm që do të çonte në bashkimin politik të dy vendeve. Bashkimi ekonomik shihej si bazament, mbi të cilin do të realizohej bashkimi i ardhshëm politik, në kuadrin e një Federate Ballkanike (me ose pa Bullgarinë), apo si një Republikë e 7-të e Jugosllavisë. Bullgaria, sipas Sllatiçit, mund të rronte edhe vetëm, por jo Shqipëria.⁷⁹ Bashkimi politik mbetej një detyrë e së ardhmes, i cili do të vinte natyrshëm, ndërsa do të vazhdohej të ruhej ministria e jashtme si një institucion formal, që dëshmonte për independencën e Shqipërisë. Udhëzimet e Savo Sllatiçit flisnin për bashkim federativ, por nuk e specifikonin nëse ai do të bëhej në kuadrin e Federatës Ballkanike, apo si Republikë e 7-të e Jugosllavisë Federative. Në fakt, referencat e sjella nga Sllatiçi, në lidhje me bashkimin ekonomik e deri diku edhe politik të dy vendeve, mbështesnin idenë e bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë si Republikë e 7-të e saj, dhe jo si një vend anëtar me të drejta të barabarta brenda Federatës Ballkanike. Përfaqësuesi jugosllav, kur fliste për bashkimin ekonomik të dy vendeve, i referohej përvojës së brendshme ekonomike të republikave jugosllave dhe raporteve të tyre me Federatën Jugosllave.

dhe, me premtimin se të nesërmen do t'i tregonte të gjitha me hollësi. Shih: Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë: Ideart, 2004, f. 331.

⁷⁶ Molotov-i gjatë një bisede të zhvilluar me Enver Hoxhën më 11 qershor 1948 e karakterizonte humbjen e Nako Spirut me fjalët: “me personin e Nako Spirut, Shqipëria humbi punëtorin e saj të mirë dhe mikun e BRSS”. Shih: *Vostoçnaja Evropa v Rossijskih Arhivov ...*, Tom I, f. 679-680. Nga ditari i V. M. Molotov-it, ABP RF, F. 06, Op. 10, P. 27, D. 334. L. 1-4.

⁷⁷ AQSH, F. 14/AP, V. 1947, D. 3, Lista 3, fl. 20-25.

⁷⁸ Po aty, F. 147AP, V. 1947, D. 40, Lista 1, fl. 1-6. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të PKSH, 7 dhjetor 1947.

⁷⁹ Po aty, fl. 2.

Savo Sllatiç-i bëri vërejtje edhe për marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike, duke këmbëngulur që marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve të kalonin përmes Jugosllavisë. Shqiptarët, sipas tij, duhej që të konsultoheshin më parë me jugosllavët. Kritikat u përqendruan tek veprimtaria e këshilltarëve sovjetikë në Shqipëri dhe tek përvoja ‘negative’ e bashkëpunimit të tyre me Nako Spirun. Ai kërkoi që këshilltarëve sovjetikë t’u bëhej e qartë, që të mos dilnin jashtë skemave të planifikimit dhe të metodologjisë jugosllave. Dukej qartë se, jugosllavët nuk e duronin dot dualitetin me BS, në rrethanat kur atyre u ishte njohur një rol i veçantë në Shqipëri. Byroja Politike i miratoi udhëzimet e përfaqësuesit të lartë jugosllav. “Gjithë shokët u shfaqën dakord me pikëpamjen jugosllave dhe me diskutimet e tyre. U ngarkua shoku komandant [Enver Hoxha] dhe Koçi [Xoxe] për të përpiluar në bazë të pikëpamjes jugosllave dhe të diskutimeve të shokëve përgjigjen që duhet ti jepej KQ të PKJ për bashkëpunimin që mendojmë ne, në të tashmen dhe në të ardhshmen”.⁸⁰

Shqetësimet për zhvillimet jonormale të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave dhe dyshimet për ndikimin negativ të misionit diplomatik sovjetik mbi Tiranën, Tito ia paraqiti edhe Moskës. Në fund të muajt nëntor, ai udhëzoi ambasadorin jugosllav në Moskë, V. Popoviç-in që të takonte Stalinin, ndërsa vetë u takua me ambasadorin e BS në Beograd, A.I. Llavrentjev-in.⁸¹

Më 17 janar 1948, Milovan Gjilas i shoqëruar nga K. Popoviç dhe Vukmanoviç Tempo u takuan në Kremlin me Stalinin, Molotovin dhe Zhdanovin. Pala sovjetike e rikonfirmoi rolin predominant të Jugosllavisë në Shqipëri, por nuk e pranoi kërkesën e tij për tërheqjen e specialistëve të BS nga Shqipëria. Shprehja e artikuluar nga Stalini në këtë takim se, ‘Jugosllavia duhet ta gëlltisë Shqipërinë’, nga historianët sovjetikë, dhe nga vetë Milovan Gjilasi është konsideruar si provokacion..., për të parë reagimet e udhëheqësit jugosllav. Rinjohja e rolit prej ‘gardiani’, të Jugosllavisë mbi Shqipërinë, duket e dyshimtë për disa arsye: *së pari*, Departamenti i Politikës së Jashtme të BS më herët kishte shfaqur rezerva ndaj rolit të PKJ, si ‘parti udhëheqëse në Ballkan’ dhe, xhelozisë së shfaqur prej saj, ndaj lidhjeve direkte të BS me Shqipërinë; *së dyti*, ambasadori Llavrentjev dhe atasheu ushtarak sovjetik në Beograd,

⁸⁰ *Po aty*, fl. 6.

⁸¹ *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse, 1946-1962...*, f. 69-70, 71-72.

gjenral-major G. D. Sidoroviç kishin dërguar informacione kritike në Moskë, në lidhje me natyrën lokaliste dhe me nuanca jo marksiste të udhëheqjes politike të Jugosllavisë e madje të vetë Tito-s, të cilat vështirë të mos merreshin në konsideratë nga udhëheqja e lartë e BS. Sjellja e Jugosllavisë në rajon shihej si sfidë për Kremlinin, i cili e shihte veten si të vetmen qendër të lëvizjes komuniste në botë dhe i vetmi udhëheqës i Bllokut Sovjetik; *së treti*, udhëheqja sovjetike ishte e informuar mirë për mosmarrëveshjet shqiptaro-jugosllave dhe për vetëvrasjen e Nako Spirut. Stalini e frenoi sërish bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Ai u shpreh se, “nuk ishte e nevojshme që të nxitoheshin në lidhje me bashkimin zyrtar të Shqipërisë me Jugosllavinë, por duhej të pritej një moment më i përshtatshëm”.⁸²

Pasi u “sigurua” për mbështetjen e udhëheqjes së lartë të BS, PKJ i avancoi më tej kërkesat e saj ndaj Shqipërisë. Më 19 janar 1948, Rankoviçi i dërgoi Enver Hoxhës një telegram në emër të Tito-s, ku i shkruante: “shoku marshall propozon të miratoni që sektori i Korçës të shpallet si bazë e jona ushtarake, me qëllim që të vendosim një divizion tonin, për të siguruar mbrojtjen e përbashkët të kufijve”.⁸³ Më 20 janar, Enver Hoxha e miratoi kërkesën e Tito-s.⁸⁴ Milovan Gjilas-i, në kujtimet e tij ka shkruar se “Tito aktualisht dëshironte të dërgonte trupat e tij, që të fuqizonte pozitën e Jugosllavisë në Shqipëri”.⁸⁵ Ndonëse u shpreh parimisht për futjen e divizionit ushtarak jugosllav në Shqipëri, madje edhe për bashkimin e dy ushtrive nën një komandë të vetme, Enver Hoxha njoftoi edhe misionin e BS në Tiranë, i cili vuri në dijeni Moskën. Kjo e fundit ishte njoftuar në mënyrë urgjente më 21 janar edhe nga ambasadori sovjetik në Beograd, Llavrentjevi. Kërkesa e Titos për të futur divizionin ushtarak jugosllav në Shqipëri u bë pa dijeninë e Stalinit dhe të udhëheqjes sovjetike.

⁸² L. Gibianskii, “The Beginning of the Soviet-Yugoslav Conflict...”, f. 471, AJBT-KMJ, 1-3-b/651 1. 10-11; Milovan Djilas, *Razgovori sa Staljinom*, Književne novine Neograd: 1990, 93-95; Milovan Djilas, *Vlast i pobuna*, Književne novine Beograd: 1991, f. 127-128.

⁸³ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1944-1948...*, vëll. I, f. 547, AJ. F. 507, IX, 1/1-154, bt. listova 2.

⁸⁴ *Po aty*, f. 547-548, AJ. F. 507, IX, 1/1-154, bt. listova 2; L. Gibianskii, “The Beginning of the Soviet-Yugoslav Conflict...”, f. 474.

⁸⁵ M. Djilas, *Vlast i pobuna* ..., f. 125.

Në takimin e delegacioneve të BS, Jugosllavisë dhe Bullgarisë, të mbajtur në Moskë më 10 shkurt 1948, Stalini e ndaloi dërgimin e trupave jugosllave në Shqipëri, duke lënë të kuptohet se ‘jugosllavët i frikësohen pranisë ruse në Shqipëri dhe, për këtë arsye po nxitojnë që të dërgojnë trupat e tyre në këtë vend’. Gjithashtu i paralajmëroi sërish jugosllavët për nxitimin që po shfaqnin, në lidhje me bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë.⁸⁶ Stalini kërkoi që fillimisht të bashkoheshin në një federatë Jugosllavia me Bullgarinë dhe pastaj të dyja me Shqipërinë. Bashkimi i Shqipërisë me Jugosllavinë, sipas Leonid Gibianskii-t, jo vetëm që u shty përsëri për më vonë, por gjithçka u ndryshua dhe, në vend që të gëlltiste në të vërtetë Shqipërinë, Jugosllavia do të ishte vetë, thjesht, një nga tre anëtarët e federatës të propozuar nga Stalini.⁸⁷ Udhëheqja jugosllave e konsideroi propozimin e Stalinit si një truk të tij për të kontrolluar Jugosllavinë dhe Titon, prandaj ajo e refuzoi atë, pas takimit të 10 shkurtit.

Udhëheqja jugosllave nuk u pajtua me vendimet e marra në Moskë më 10 shkurt në lidhje me Shqipërinë. Më 1 mars 1948 Byroja Politike e PKJ vendosi t’i avanconte më tej kërkesat e saj ndaj Shqipërisë. Tito dhe udhëheqja e PKJ e ripërsëritën kërkesën për futjen e trupave jugosllave në Shqipëri dhe për bashkimin e dy vendeve. Udhëheqja shqiptare, e cila nuk kishte dijeni për takimin e 10 shkurtit, parimisht e pranoi kërkesën e Jugosllavisë për vendosjen e divizionit jugosllav në Shqipëri, por praktikisht e zvarriti zbatimin e tij, në pritje të njohjes me mendimin e udhëheqjes së Bashkimit Sovjetik.⁸⁸ “Ka momente të reja, i shkruante Savo Sllatiç-i nga Tirana, Aleksandër Rankoviç-it, që flasin për mungesën e sinqeritetit të Enverit dhe të tjerëve”.⁸⁹ Çuvahini nga ana e vet i konsideronte të pabazuara fjalët e përhapura nga jugosllavët në lidhje me rrezikun që i paraqitej Shqipërisë nga ndonjë sulm i mundshëm i Greqisë. Sipas tij, “një mendim të tillë e përkrahin vetë anglo-amerikanët me qëllim që të krijojnë një psikozë lufte në vendet e tyre...”⁹⁰

⁸⁶ L. Gibianskii, “The Beginning of the Soviet-Yugoslav Conflict...”, f. 475.

⁸⁷ Po aty, f. 475. Takimi i 10 shkurtit 1948 dhe përfundimet e tij janë shqyrtuar në bazë të dokumenteve të reja arkivore ruse, jugosllave dhe bullgare.

⁸⁸ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1944-1948...*, vëll. I, f. 552.

⁸⁹ Po aty, f. 562.

⁹⁰ Po aty, f. 555. Nga biseda e Josip Gjergjas me Çuvahinin, 10 mars 1948.

Më 18 mars 1948, qeveria sovjetike kishte dhënë urdhër për tërheqjen e specialistëve të tyre ushtarakë dhe civilë nga Jugosllavia. Ajo kishte urdhëruar gjithashtu tërheqjen e këshilltarëve të saj nga Shqipëria. Por, më 13 prill, pas kërkesës së qeverisë shqiptare, ajo e anuloi urdhrin e mëparshëm. Ky veprim u prit keq nga gjenerali jugosllav në Shqipëri-Kupershanini, i cili si kundërpërgjigje, dy ditë më pas kërkoi tërheqjen e instruktorëve dhe përfaqësuesve ushtarakë të vendit të tij nga Shqipëria. Megjithëse, Enver Hoxha i dërgoi Titos një telegram me kërkesën që ta ‘shtynte urdhrin’ e dhënë, ai nuk u ndryshua.⁹¹ Marrëdhëniet po shkonin drejt prishjes së plotë, ndërsa plani për dërgimin e divizionit ushtarak jugosllav në Shqipëri kishte marrë fund.

Plani i Jugosllavisë për bashkimin e saj me Shqipërisë gjithashtu u ndërpre. Pa dyshim një rol të veçantë ka patur Stalini, i cili parimisht e ka mbështetur idenë e krijimit të Federatës Ballkanike, ku do të përfshihej edhe Shqipëria, por në planin afatshkurtër e ka penguar e frenuar krijimin e saj. Ngjarjet që ndodhën në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në fund të vitit 1947 dhe në fillim të vitit 1948 krijojnë idenë se, çështja e bashkimit të dy vendeve ishte në rrugën e realizimit. Mënyra se si do të realizohej bashkimi, nëse Shqipëria do të ishte një vend me të drejta të barabarta me Jugosllavinë dhe Bullgarinë në kuadrin e Federatës Ballkanike, apo si një Republikë e 7-të e Jugosllavisë Federative, mbetet e diskutueshme. Po kështu, i dyshimtë mbetet edhe versioni i bashkimit të Shqipërisë me Kosovën në një shtet të përbashkët. Dokumentet e njohura nuk i japin përgjigje të qartë kësaj çështjeje që i përkiste perspektivës.⁹² Në takimin me Enver Hoxhën në Beograd, në qershor 1946, Tito ishte shprehur se “brenda Federatës Ballkanike çështja e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë do të ishte shumë më e lehtë”.⁹³ Këtë version të Tito-s e ka konfirmuar edhe Stalini, në takimin e zhvilluar me Enver Hoxhën në nëntor 1949, në qytetin e Sukum-it.

⁹¹ *Po aty*, f. 563.

⁹² *AQSH*, F. 14/AP, V. 1947, Dosja 3, Lista 3, fl. 14-25. “Mbi disa probleme të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave”, shënime nga biseda e Enver Hoxhës me Savo Sllatiç-in më 4 nëntor dhe 5 dhjetor 1947; *po aty*, F. 14/AP, V. 1947, D. 20, Lista 1, fl. 2. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të PKSH, 7 dhjetor 1947, Savo Sllatiç: “...se si do bëhet më vonë, a do të bashkohemi në një shtet, kjo është një gjë tjetër e do të vijë nga vullneti i popullit, i Partisë dhe i Komitetit Central. Vetëm them se kjo është rruga që do të ecin popujt tanë në një bashkim të tillë” [federativ- H.K.]; *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1944-1948...*, vëll. I, f. 155-156.

⁹³ E. Hoxha, *Titistët...*, f. 261.

“Kosova dhe Metohia, citohet të ketë thënë Stalini, do të mund të hynin në kuadrin e Republikës Popullore të Shqipërisë..., version me të cilin kishte qenë dakord edhe Titua”.⁹⁴ Idenë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë e ndeshim edhe në një udhëzim të Titos për Enver Hoxhën, të përcjellë nga Savo Sllatiç-i në marsin e vitit 1948, në të cilin thuhej se, “kishte ardhur koha që populli shqiptar të grumbullohej në një shtet të vetëm”.⁹⁵

Premtimi i Titos për të bashkuar shqiptarët e Kosovës e të Shqipërisë në një shtet të vetëm, në kuadrin e Federatës Ballkanike apo si Republikë e 7-të e Jugosllavisë Federative duket i dyshimtë, për të mos thënë që ishte thjesht një manovër e tij, për të joshur shqiptarët, në rrethanat emergjente të krijuara nga konflikti i Jugosllavisë me BS. Në rrethanat kur udhëheqja jugosllave e kishte ‘çliruar’ veten nga detyrimet për të zbatuar urdhrat e BS, kur e kishte refuzuar idenë e Stalinit për bashkimin e shpejtë të Jugosllavisë me Bullgarinë, do të ishte shumë e vështirë të besohej se udhëheqja jugosllave do ta pranonte Shqipërinë si një vend i barabartë me Jugosllavinë, në kuadrin e Federatës Ballkanike. Po kështu i dyshimtë mbetet edhe premtimi i tij për bashkimin e shqiptarëve të dy anëve të kufirit. “Lëshimi” i shpallur nga Tito, duket se ka qenë i kushtëzuar nga rrethanat e vështira të krijuara në atë këtë kohë në marrëdhëniet jugosllavo-sovjetike, të cilat po shkonin drejt fundit dhe kur udhëheqja e lartë jugosllave po përpiquej të mos humbte edhe Shqipërinë, për të cilën kishte investuar jo pak, gjatë dhe sidomos pas mbarimit të Luftës.

Kthesa reale në qëndrimin e udhëheqjes sovjetike ndaj Jugosllavisë ndodhi pasi Moskua u informua për vendimet e mbledhjes së Byrosë Politike të PKJ të datës 19 shkurt, të cilat synonin avancimin e marrëdhënieve me Shqipërinë, kundër urdhrave të Stalinit të datës 10 shkurt. Por, duhet përmendur se rezultatet e takimit të 10 shkurtit nuk iu bënë të njohura udhëheqjes shqiptare. Letra e datës 27 mars, që KQ i PK(B) i dërgoi i dërgoi KQ të PKJ dhe Titos, me firmën e Stalinit dhe të Molotovit, përmbante akuza për ndjekjen e vijës antisovjetike të udhëheqjes jugosllave, por ajo nuk i përfshinte mosmarrëveshjet e

⁹⁴ *AQSH*, F. 14/AP, V. 1949, D. 20, fl. 6-6/1. Nga takimi i J. V. Stalin-it me Enver Hoxhën në Sukum, nëntor 1949.

⁹⁵ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1945-1948, Dokumente*, përgatitur për botim nga Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 1996, f. 13.

Jugosllavisë me Shqipërinë. Por, nuk mund të thuhet se udhëheqja shqiptare dhe ca më shumë Enver Hoxha nuk ishin fare të painformuar. Byroja Politike e KQ të PKSH u njoh me letrën e BS më 23 prill, ndërsa më 27 prill iu kthye përgjigje KQ të PK(B).⁹⁶ Enver Hoxha personalisht është kritikuar më vonë për qëndrimin pritës, për frymën e kompromisit dhe për kthesën e vonuar të tij dhe të udhëheqjes shqiptare.⁹⁷ Duhet përmendur se edhe udhëheqja e PK të Bullgarisë dhe vetë Dimitrovi reflektuan me vonesë ndaj kritikave që i bëheshin Jugosllavisë nga BS, ndonëse ndryshe nga udhëheqja shqiptare, ajo kishte dijeni për konfliktin sovjeto-jugosllav, por nuk ishte në gjendje që të parashikonte përfundimin e tij.⁹⁸ Kthesa reale e udhëheqjes komuniste të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë ndodhi pas njohjes dhe solidarizimit me letrën që Byroja Informative i dërgoi PKJ në qershor 1948. Ndryshimi u zyrtarizua në Plenumin e XI të KQ të PKSH (13-24 shtator 1948) dhe sidomos në Kongresin I të PKSH, të mbajtur në nëntor të atij viti.

S u m m a r y

KOSSOVO IN THE GEOPOLITICAL CROSSROADS: ALBANIA, YUGOSLAVIA AND THE GREAT POWERS 1945-1948

Since the fall of communism, the issue of the Albanian Labor Party's stance toward the question of Kosovo has been hotly debated both in Albanian academia and public discourse. Fueled either by nationalism and lack of historical knowledge many historians, depending on their ideological or political affiliation have speculated on why the Albanian Government did not present its claims on Kosovo, at the Paris Peace Conference of 1946. By using archival sources of different provenance, the article "Kosovo in Geopolitical Crossroads: Albania, Yugoslavia and the Great Powers 1945-1948" intervenes within this controversial debate with the aim of shedding more light on it. The *introduction* of this study explains the different competing narratives that circulate today and, approaching the whole matter from a counterfactual

⁹⁶ AQSH, F.14/AP, V. 1948, L. 2, D. 5, fl. 1-7.

⁹⁷ *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse...*, f. 83. Nga letra e D. S. Çuvahin-it drejtuar M.V. Molotov-it mbi gjendjen në Partinë Komuniste Shqiptare, 17 tetor 1948, RGASPI, F. 82, I. 2, D. 1124, f. 1-16.

⁹⁸ Novica Veljanovski, "The Macedonian question - Yugoslavia and Bulgaria 1944-1953", in *Yugoslavia in the Cold War*, University of Toronto, Lubljana: 2004, f. 196.

standpoint, it tries to define whether or not the Albanian communists did have chances to successfully claim Kosovo in the international forums that established the postwar European order. Afterwards, the article expounds the argument in two main parts. Its *first part* deals 1) with the forced union of Kosovo with the Federal Republic of Yugoslavia; 2) with the attitudes of Albania, Soviet Union, USA, and Great Britain on the issue of Kosovo, in the period January 1945-June 1946. The article argues that the problem of Kosovo did not become part of an international agenda. The powers of the Antifascist Alliance did consider the question of Kosovo an internal matter of Yugoslavia and left its "official solution" in the hands of the two concerned parties: the Communist Party of Yugoslavia (CPY) and Communist Party of Albania (CPA). *The second part* of the article focuses on the problem of Kosovo in the period June 1946-June 1948. During these two years, the relations between the two communist parties moved from that of extremely close friendship to their unraveling and total break. After the conclusion of the Paris Peace Conference, the Albanian and Yugoslav leadership envisioned that the Kosovo question would be solved within the framework of the Balkan Federation, which Tito and his close associates in the CPY top-echelons were pushing forward. Initially, Stalin supported the project but later, the Soviet dictator hindered its implementation. In the course of 1947 and early 1948, the head of the Kremlin came to distrust the hegemonic ambitions of Yugoslavia in the Balkans and especially in Albania. What exacerbated Stalin's suspicion was especially Tito's independent policy towards the USSR and CPY's involvement in the Greek civil war while the armed conflict with the West was looming closer in the horizon. After the Tito-Stalin split, the ALP's leadership nurtured the illusory hope that after the regime change in Belgrade, Stalin would approve the territorial integration of Kosovo within the Albanian state. However, Stalin rejected Enver Hoxha's proposal in 1949 for a potential border change. After that, this issue was 'archived'.

This article is based on Albanian, Yugoslav, Russian, American, and British sources, as well as some important recent publications. Unlike most previous studies, this study approaches the Kosovo question not only from the narrow and local perspectives of the interested parties, i.e. Yugoslavia and Albania, but also from the broader angle of the Great Powers.

